



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 235, Datë 19.07.2023

MBI

**NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-S NR. 243, DATË 02.12.2021,
“MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË “NOA ENERGY TRADE” SH.P.K., NË
VEPRIMTARINË E FURNIZIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE”**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 113 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 19.07.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1803/2 prot., datë 14.07.2023, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes “Mbi një ndryshim në vendimin e bordit të ERE-s nr. 243, datë 02.12.2021, “Mbi licencimin e shoqërisë “NOA ENERGY TRADE” sh.p.k., në veprimtarinë e furnizimit të energjisë”,

Konstatoi se:

- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 243, datë 02.12.2021, vendosi të licencojë shoqërinë “NOA ENERGY TRADE” sh.p.k. në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, për një afat 5 vjeçar, duke i lënë kusht shoqërisë që me fillimin e operimit, të depozitojë në ERE sistemin IT.
- ERE, me shkresën nr. 1803 prot., datë 16.06.2023, i kërkoi shoqërisë informacion për sa lënë kusht në pikën 2 të vendimit nr. 243/2021.
- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1803/1 prot., datë 30.06.2023, shoqëria depozitoi kontratën për ofrimin e shërbimeve IT, të lidhur më datë 04.01.2023, me një afat 5 (pesë) vjeçar, afat i cili e mbulon gjithë periudhën e licencimit të shoqërisë “NOA ENERGY TRADE”sh.p.k.
- Për sa më sipër, rezulton se shoqëria ka plotësuar kushtin e vendosur në pikën 2 të vendimit të bordit të ERE nr. 243/2021.

- Në nenin 113 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, parashikohet e drejta e shfuqizimit të plotë apo të pjesshëm të një akti, me nismën e vet organit që e ka nxjerrë, duke përcaktuar dhe formën ligjore të këtij ndryshimi të aktit, e cila duhet të bëhet me një akt të ri me shkrim.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të shfuqizojë pikën 2 të vendimit të bordit të ERE-s nr. 243, datë 02.12.2021 “*Mbi licencimin e shoqërisë “NOA ENERGY TRADE” sh.p.k., në veprimtarinë e furnizimit të energjisë*”.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë shoqërinë “NOA ENERGY TRADE” sh.p.k., për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI